



Republika e Kosovës
Republika Kosova/Republic of Kosovo
Akademia e Drejtësisë/Akademija Pravde/Academy of Justice

**Prishtinë,
7 qershor 2023**

KONKLuzionet PËR UNIFIKIM TË PRAKTIKËS GJYQËSORE

**Punëtori me Gjyqtarët e Gjykatës së Apelit, Departamenti i Përgjithshëm-
Divizioni Penal, Departamenti për Krime të Rënda, Departamenti Special
si dhe Departamenti për të Mitur**

Më datë 7 qershor 2023, në Hotel Amazona në Vushtrri, me përkrahjen e Akademisë së Drejtësisë, është mbajtur punëtorja lidhur me unifikimin e praktikës gjyqësore, për Departamentin e Përgjithshëm-Divizioni Penal, Departamentin për Krime të Rënda, Departamentin Special si dhe Departamentin për të Mitur, ku në këtë punëtori kanë marrë pjesë kryetari i gjykatës së Apelit z.Valon Totaj, nënkryetarja Kadrije Goga Lubishtani, si dhe gjyqtarët Xhevdet Abazi, Hashim Çollaku, Tonka Berishaj, Vaton Durguti, Bashkim Hyseni, Kreshnik Radoniqi, Afërdita Bytyqi, Burim Ademi, Beqir Kalludra, Zyhdi Haziri, Skender Çoçaj dhe Rafet Haxhaj.

Punëtorja është udhëhequr nga kryetari i Gjykatës së Apelit z.Valon Totaj, udhëheqësi i Departamentit për Krime të Rënda, gjyqtari Xhevdet Abazi dhe udhëheqësi i Departamentit Special, gjyqtari Vaton Durguti, ndërsa në cilësi të procesmbajtësve kanë marrë pjesë bashkëpunëtorët profesional Artan Xhaqaj dhe Blendë Mjeku.

Në kuadër të këtij kolegji/mbledhje, janë diskutuar shumë çështje në lidhje me pyetjet që janë ngritur nga të pranishmit, ku të gjithë gjyqtarët janë pajtuar që përafrimi i mendimeve dhe i qëndrimeve gjyqësore për këto çështje të bëhet nga vetë gjyqtarët e lartcekur.

Pas diskutimeve të bëra dhe pyetjeve të ngritura, me qëllim të unifikimit të praktikës gjyqësore për këto çështje, Kolegjiumi i gjyqtarëve të Gjykatës së Apelit - Departamenti për Krime të Rënda, Departamenti Special, Departamenti i Përgjithshëm – Divizioni Penal dhe Departamenti për të Mitur, ka ardhur në këto konkluzione:

1. Në rastet kur nevojitet të mbahen seancat e kolegjit në Gjykatën e Apelit, kur palët mungojnë dhe janë të ftuara (njoftuara) në mënyrë të rregullt, a duhet të mbahen seancat?

Konkluzion:

Në rastet kur palët njoftohen në mënyrë të rregullt dhe nuk marrin pjesë, seanca vazhdon të mbahet.

2. Te çështja kur gjykata e shkallës së parë ka marrë aktgjykim lirues, a duhet të mbahet seanca e kolegjit në Gjykatën e Apelit?

Konkluzion:

Në rastet kur gjykata e shkallës së parë ka marrë aktgjykim lirues, Gjykata e Apelit duhet të caktojë seancë duke u bazuar në nenin 390.1 të KPPK.

3. Në rastet kur është shqiptuar dënimi me gjobë apo dënimi me kusht ndërsa ankesa është parashtruar vetëm sa i përket vendimit mbi dënimin, a duhet të caktojë seancë kolegji i Gjykatës së Apelit?

Konkluzion:

Në secilin rast që është shqiptuar dënimi me gjobë apo dënimi me kusht, ndërsa ankesa është parashtruar vetëm sa i përket vendimit mbi dënim atëherë nuk duhet të caktohet seancë, ndërsa në rastet tjera kur ankesa i ka përfshirë të gjitha bazat ankimore atëherë duhet të caktohet seanca e kolegjit në Gjykatën e Apelit.

4. Në rastet kur mbrojtja është e detyrueshme ndërsa në seancë mungon mbrojtësi i të akuzuarit, a duhet të mbahet seanca e kolegjit në Gjykatën e Apelit?

Konkluzion:

Në këto raste neni 390 i KPPK, e rregullon prezumimet për mbajtjen e seancës së kolegjit dhe ky nen ka përparësi në zbatim në krahasim me dispozitën e nenit 56 KPPK.

5. Te çështja e lirimit të parakohshëm, kur gjykata e shkallës së parë refuzon kërkesën apo të njëjtën e aprovon vetëm për një muaj, si duhet të veprohet?

Konkluzion:

Kërkesa për lirim të parakohshëm duhet të aprovohet për 3 muaj aq sa e parasheh ligji, ndërsa e njëjta kërkesë duhet të refuzohet vetëm në rastet kur i dënuari ka bërë shkelje disiplinore gjatë vuajtjes së dënimit.

6. Te çështja e udhëzimeve të Gjykatës së Apelit me rastin e anulimit të vendimit të gjykatës së shkallës së parë, si duhet të veprohet?

Konkluzion:

Në rastet kur aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë është i përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës penale dhe nëse kemi të bëjmë me shkelje absolute, nuk ka nevojë që gjykata e shkallës së dytë të lëshohet në pretendime tjera ankimore që kanë të bëjnë me gjendjen faktike.

7. Te çështja e kualifikimit të veprës penale, në praktikë ka raste të ndryshme kur aplikohen dy paragrafë të nenit e që ka të bëjë me cilësimin juridik të veprës penale, si duhet të veprohet në këto raste?

Konkluzion:

Në këto raste duhet të shkohet vetëm me një kualifikim të veprës penale dhe duhet të merret ai që është bazament për figurën e veprës penale, ndërsa paragrafët e tjerë mund të merren vetëm si rrethana rënduese në matjen e dënimit.

(Gj. Beqir Kalludra dhe Kreshnik Radoniqi mendojnë se kualifikimi i veprës penale, mund të jetë edhe me më shumë se një paragraf).

8. Te çështja kur kemi të bëjmë me bashkëkryerje të veprës penale dhe njëri i akuzuar është i paarritshëm ndërsa tjetri është shpallur fajtor, në këto raste a duhet të ceket në dispozitiv bashkëkryerësi i cili ka qenë i paarritshëm por që të njëjtit i dihet identiteti?

Konkluzion:

Në këto raste në dispozitiv të aktgjykimit duhet të ceket edhe identiteti i bashkëkryerësit i cili për momentin është i paarritshëm për gjykatën.

9. Në rastet kur në dispozitiv të aktgjykimit caktohet shuma e dëmit, mirëpo i njëjti udhëzohet në kontest civil, a përbënë kjo shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale?

Konkluzion:

Në rastet kur shuma e kompensimit të dëmit caktohet në dispozitiv, e po ashtu i njëjti udhëzohet në kontest civil, atëherë kjo paraqet shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale.

10. Te çështja kur tek bashkëkryerësit, njëri e pranon fajësinë dhe tjetri nuk e pranon si duhet të veprohet?

Konkluzion:

Në rastet të tilla mund të pranohet pranimi i fajësisë bashkëkryerësit dhe të shkohet me shqiptim të dënimit nëse plotësohen kushtet ligjore për pranimin e fajësisë (rrethanat faktike), ndërsa vazhdon procedura me bashkëkryerësin i cili nuk e ka pranuar fajësinë.

11. Në rastet kur gjyqtari për të mitur vepron në procedurë paraprake, i njëjti a ka të drejtë të veprojë si gjyqtar për të mitur?

Konkluzion:

Lidhur me këtë çështje do të bëhet kërkesë për dhënie të mendimit juridik nga Gjykata Supreme e Kosovës.

12. Kur në seancën e kolegjit pranë Gjykatës së Apelit, i akuzuari është me çrregullime mendore, a duhet të ftohet eksperti për të konstatuar gjendjen mendore të të akuzuarit?

Konkluzion:

Në raste të tilla në seancën e kolegjit pranë Gjykatës së Apelit, nuk mund të marrë pjesë eksperti i psikiatrisë për të konstatuar aftësinë e të pandehurit për të përballuar gjykimin. I njëjti do të ftohej vetëm nëse kolegji i Gjykatës së Apelit vendos të hap shqyrtim.

13. Në rastet kur Gjykata e Apelit konstaton se aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë është përfshirë në shkelje relative të dispozitave të procedurës penale, si duhet të vepohet në këtë rast?

Konkluzion:

Në raste të tilla kur aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë është përfshirë në shkelje relative të dispozitave të procedurës penale, atëherë fillimisht nëse ekzistojnë kushtet për ndryshimin e aktgjykimit të gjykatës së shkallës së parë, i njëjti duhet të ndryshohet, por nëse i njëjti duhet të anulohet atëherë kolegji i Gjykatës së Apelit, duhet t'i specifikojë saktë veprimet që duhet të ndërmerren në ri procedurë.

Arritja e objektivave të punëtorisë

Lidhur me arsyeshmerinë e mbajtjes dhe objektivat e arritura theksojmë se punëtorinë e ka karakterizuar një frymë e lartë profesionalizmi dhe një përkushtim i theksuar, që nga puna në grupe dhe parashtrimi i propozimeve, e deri tek zhvillimi i debatit për secilën pikë të propozuar dhe arritja në konkluzionin përfundimtar për pikën e diskutuar. Debatin e ka karakterizuar një nivel i lartë i profesionalizmit dhe dhënies së mendimeve mbi zgjidhjet e ofruara, niveli i lartë i respektimit të kohës dhe mendimit të tjetrit e deri tek të vendosurit lidhur me miratimin dhe konkluzionin përfundimtar.

Për çështjet për të cilat ka pasur pajtim të plotë është vendosur me njëzëri, ndërsa për çështjet që ka pasur diskutime paksa më të gjata është vendosur me shumicën e votave. Mendimet ndryshe janë cekur në pjesët shtesë të konkluzioneve.

Si përfundim i të cekurave si më lartë, vlen të theksohet se iniciativa për mbajtjen e një takimi të tillë dhe metodologjia e punës brenda punëtorisë, është vlerësuar lartë nga pjesëmarrësit për çka është ardhur në konkludim se kjo punëtori ishte tejet e suksesshme dhe se konkluzionet e nxjerra do lehtësojnë punë e gjyqtarëve të Gjykatës së Apelit dhe jo vetëm, në të ardhmen.

Theksojmë se sukcesi i arritur në këtë takim, nuk do të ishte i mundur pa mbështetjen e Këshillit Gjyqësor të Kosovës (KGJK), kryetarit të Gjykatës së Apelit Valon Totaj, Kolegjiut të gjyqtarëve të Departamentit të Përgjithshëm-Divizionit Penal, Departamenti për Krime të Rënda, Departamenti Special si dhe Departamenti për të Mitur.

Një falënderim i veçantë për Akademinë e Drejtësisë, për përkrahjen dhe mundësimin e kësaj punëtorie.

Nga një kopje t'u dërgohet:

Të gjithë gjyqtarëve të Gjykatës së Apelit të Kosovës;

Këshillit Gjyqësor të Kosovës;

Arkivës së Gjykatës së Apelit të Kosovës; dhe

Akademisë së Drejtësisë